



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 140 Datë 08.10.2012

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SH.A PËR
PERIUDHEN E TRETË RREGULLATORE 2012 – 2014 NË ZBATIM
TE “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR
KOMPANINË PUBLIKE TË PRODHIMIT”**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për gjenerimit publik”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014 në zbatim të “Metodologjise se llogaritjes se tarifave per kompanine publike te prodhimit”,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014, në zbatim të “Metodologjise së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të prodhimit”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI